



KOMUNA VUSHTRRI

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN

02 Nr. / Br 853/20

Nr. i fq. / Br. st -03-

Data: / Datum 08.10.2020

VUSHTRRI - VUČITRN



KOMUNA OBILIQ

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI
PËR FINANCIMI TË PËRBASHKËT TË PROJEKTIT

Palët nënshkruese të marrëveshjes,

- Komuna e Vushtrrisë, e përfaqësuar nga **z. Xhafer Tahiri**, Kryetari i Komunës (në tekstin e mëtejme Komuna)
- Komuna e Obiliqit, përfaqësuar nga **z. Xhafer Gashi**, Kryetar i Komunës (në tekstin e mëtejme Komuna)

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i lidhjes së kësaj marrëveshje është financimi i përbashkët i projektit "Pastrimi i shtratit të lumit nga fshati Kozaricë, Brezhnicë, Stanoc i Epërm, Stanoc i Poshtëm deri në derdhjen në lumin Llab".

Neni 2
Financimi i projektit

Vlera e tërësishme e projektit është 79,216.00 € (shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë euro) nga të cilat:
Komuna e Vushtrrisë do të siguroj 24,216.00 € (njëzetekatërmijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë euro) ndërsa Komuna e Obiliqit do të participoj në këtë projekt me 55,000.00 € (pesëdhjetë e pesë mijë euro).

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIC

DREJTORIA E ADMANISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE

Dalës-Izlazna

Nr. 11-1146 Data 09.10.2020

Br. Datum

OBILIQ-OBILIC

Neni 3

Obligimet e Komunës së Vushtrrisë

- 3.1 Komuna e Vushtrrisë merr përsipër të zbatoj procedurat e prokurimit për realizim të këtij projekti konform ligjit në fuqi për prokurimin publik.
- 3.2 Komuna e Vushtrrisë cakton menaxherin/organin mbikëqyrës për mbikëqyrjen e realizimit të projektit si dhe për inspektimin final të punimeve/pranimin teknik.
- 3.3 Menaxheri i projektit përkatësisht organi mbikëqyrës, me përgjegjësi të plotë vërteton kualitetin e punëve të kryera në bazë të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar për pagesën e punëve të kryera në bazë të kushteve të kontratës.
- 3.4 Komuna e Vushtrrisë do ta njoftoj Komunën e Obiliqit për rrjedhat e realizimit të projektit deri në përfundimin e tij.

Neni 4

Obligimet e komunës së Obiliqit

- 4.1 Komuna e Obiliqit merr përsipër që para fillimit të procedurave të prokurimit të ia dorëzoj komunës së Vushtrrisë dëshminë për zotim të mjeteve për këtë projekt.
- 4.2 komuna e Obiliqit do të caktoj një zyrtar profesional i cili do të bashkëpunoj me organin mbikëqyrës të Komunës së Vushtrrisë për përcjellje të realizimit të projektit nga kjo marrëveshje.

Neni 5

Realizimi i Projektit

Komuna e Vushtrrisë dhe komuna e Obiliqit do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme procedurale dhe punëve në terren që projekti të përfundoj gjatë vitit buxhetor 2020. Në rast se gjatë vitit 2020 për shkaqe të arsyeshme (fuqia madhore etj.) nuk kryhet ky projekt, të gjitha obligimet e palëve të kësaj marrëveshje barten në vitin vijues 2021.

Neni 6

Ndryshimet dhe ndërprerja e marrëveshjes së mirëkuptimit

- 5.1 Me pëlqimin paraprak të Kryetarit Komunës së Vushtrrisë dhe Kryetarit të Komunës së Obiliqit, kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit mund të ndryshohet dhe plotësohet.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve


Palët pajtohen që mosmarrëveshjet eventuale të i zgjidhin përmes konsultave me mirëkuptim të ndërsjellë.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Palët nënshkruese pajtohen që marrëveshje e mirëkuptimit të hyn në fuqi dhe fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

Neni 9
Numri i ekzemplarëve

Marrëveshja e mirëkuptimit është përpiluar dhe nënshkruar në katër ekzemplarë, nga dy për secilën palë nënshkruese.

Komuna e Yushtrisë

Xhafer Tahiri, Kryetar



Komuna e Obiliqit

Xhafer Gashi, Kryetar

